

VENDIM
Nr.165, datë 3.3.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Anila Kaçupi shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)